

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 22.01.2022

Problemi 1

Më 31 gusht 2020, është paraqitur ekstrakti i mëposhtëm nga pasqyra e pozicionit financiar të Sara shpk:

Pasuritë jo qarkulluese	Kosto €	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera neto
Pajisjet	60,000	24,000	36,000
Kompjuteret	<u>8,000</u>	<u>5,600</u>	<u>2,400</u>
	<u>68,000</u>	<u>29,600</u>	<u>38,400</u>

Gjatë vitit që përfundon më 31 gusht 2021 ndodhën transaksionet e mëposhtme:

1. Më 31 janar 2021, ishin shitur për 10,000 eur pajisjet e blera më 1 prill 2018, me kosto të blerjes 28,000 eur. Shuma është arkëtuar në tërësi.
2. Më 1 shkurt 2021 është blerë një pajisje e re me kosto prej 35,000 eur.
3. Në muajin mars 2021 janë blerë kompjuterë për 600 eur.

Sara ka politikën e zhvlerësimit si në vijim:

- (i) Pajisjet zhvlerësohen me 20% në vit me metodën drejtvizore.
- (ii) Kompjuterët zhvlerësohen me 25 % në vit me metodën e saldove zbritëse.
- (iii) Kompania ngarkon zhvlerëimin e plotë në vitin e blerjes.
- (iv) Kompania nuk ngarkon fare zhvlerësim në vitin e shitjes.

Kërkohet:

- a) Përgatitni kontot T për pasuritë me kosto dhe zhvlerësimin e akumuluar, për vitin që përfundon më 31 gusht 2021. **(10 pikë)**
- b) Regjistroni shitjen e pasurisë jo-qarkulluese më 31 janar 2021. **(10 pikë)**

Total 20 pikë

Zgjidhja e problemit 1

a)

Pajisjet (Kosto)

S` 60,000	Shitja 28,000
Blerja 35,000	
S`` 67,000	

Zhvlerësimi i akumuluar (Pajisjet)

Shitja 16,800*	S` 24,000
	Shpenzimet e zhvlerësimit 13,400**
	S`` 20,600

Kompjuterët (Kosto)

S` 8,000	
Blerja 600	
S`` 8,600	

Zhvlerësimi i akumuluar (Kompjuterët)

	S` 5,600
	Shpenzimet e zhvlerësimit 750***
	S`` 6,350

*Zhvlerësimi vjetor i pasurisë së shitur= $28,000 \times 20\% = 5,600$
Zhvlerësimi i akumuluar për (2018,2019,2020)= $5,600 \times 3 \text{ vite} = 16,800$
Në vitin 2021 viti i shitjes, nuk ngarkohet zhvlerësim.

** Zhvlerësimi vjetor (Pajisje)= $20\% \times 67,000 = 13,400$

*** Zhvlerësimi vjetor (Kompjuterët)= $25\% \times (8,600 - 5,600) = 750$

b) Cmimi shitës i pasurisë 10,000

VNL e pasurisë së shitur (28,000-16,800) 11,200

Humbje në shitje 1,200

Debi: Paraja 10,000

Debi: Humbja kapitale 1,200

Debi: Zhvlerësimi i akumuluar 16,800

Kredi: Pajisjet (Kosto) 28,000

Problemi 2

Bilanci vërtetues i kompanisë Vesa shpk më 30 qershor 2021

	Debi`000	Kredi`000
Kapitali aksionar		50,000
Premia në aksione		25,000
Rezerva e rivlerësimit më 1 korrik 2020		10,000
Toka dhe ndërtesat(Kosto)	120, 000	
Zhv. i akumuluar (ndërtesa) më 1 korrik 2020		22,500
Impijantet dhe pajisjet (Kosto)	32,000	
Zhv. i akumuluar (pajisje)më 1 korrik 2020		18,000
Llogaria e arkëtueshme	20,280	
Llogaria e pagueshme		8,725
5% Kredi bankare 2015		20,000
Paraja e gatshme	2,213	
Fitimet e mbajtura më 1 korrik 2020		12,920
Shitjet		100,926
Blerjet	67,231	
Shpenzimet e shpërndarjes	8,326	
Shpenzimet administrative	7,741	
Stoqet më 1 korrik 2020	7,280	
Dividentat e paguar	3,000	

Informacioni i mëposhtëm është i rëndësishëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare:

- (i) Stoqet më 30 qershor 2021 ishin 9,420,000 eur.
- (ii) Zhvlerësimi për vitin që përfundon më 30 qershor 2021:
 - Ndërtesat 4% në vit – Metoda drejtvizore
 - Impijantet e prodhimit dhe pajisjet-20% në vit-Metoda e saldove zbritëse

Pjesa e tokës në Bilancin Vërtetues është me kosto prej 40,000,000 eur. Më 30 qershor 2021, rivlerësuesi ia kishte vendosur vlerën e tregut prej 54,000,000 eur. Ky rivlerësim duhet të përfshihet në Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 30 Qershor, 2021.

- (iii) Duhet të shlyhet borxhi prej 540,000 eur si borxh i keq.
- (iv) Përfshirë në shpenzimet e shpërndarjes është një shumë prej 2,120,000 eur lidhur më një kampanjë reklamuese e cila do të fillojë më 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021.
- (v) Shpenzimi i interesit të kredisë nuk është përfshirë në Bilancin Vërtetues.
- (vi) Shpenzimet e tatimit për vitin janë 2,700,000 eur.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 1, përgatitni;

- a) Pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 30 qershor 2021. **15 pikë**
- b) Pasqyrën e pozicionit financiar më 30 qershor 2021. **15 pikë**

Zgjidhja e problemit 2

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 30 qershor 2021

	€'000
Të hyrat nga shitja	100,926
KMSH (LL1)	<u>(65,091)</u>
Fitimi bruto	35,835
Shpenzimet e shpërndarjes (LL2)	(7266)
Shpenzimet e borxheve të këqija	(540)
Shpenzimet administrative	(7,741)
Shpenzimet e zhvlerësimit (LL/3)	<u>(6,000)</u>
Fitimi operativ	14,288
Shpenzimet e interesit (LL4)	<u>(1,000)</u>
Fitimi para tatimit	13,288
Shpenzimet e tatimit (LL/5)	(2,700)
Fitimi neto	10,588

Pasqyra e pozicionit financiar më 30 qershor 2021

	€'000
Pasurite jo qarkulluese	
Patundshmerite, impijantet e prodhimit dhe pajisjet (LL6)	119,500
Pasurite qarkulluese	
Stoqet	9,420
LL/ A (LL7)	19,740
Parapagimet	1,060
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet	<u>2,213</u>
Total pasurite	<u>151,933</u>
Ekuiteti	
Kapitali aksionar	50,000
Premia ne aksione	25,000
Fitimi i mbajtur (LL8)	20,508
Rezerva e rivlerësimit (10,000+14,000)	24,000
Detyrimet afatgjata	
5% Kredia afatgjate	20,000
Detyrimet afatshkurta	
LL/P	8,725
Interesi i pagueshem	1,000
Tatimi i pagueshem	<u>2,700</u>
Total detyrimet	<u>32,425</u>
Ekuiteti dhe detyrimet	<u>151,933</u>

(LL1) KMSH

	´000
Stoqet në fillim	7,280
Blerjet	67,231
Minus Stoqet në fund	<u>(9,420)</u>
	<u>65,091</u>

(LL2) Shpenzimet e shpërndarjes

	´000
Sipas BV	8,326
Parapagimet e marketingut $(2,120 \times \frac{6}{12})$	<u>(1,060)</u>
	<u>7,266</u>

(LL3) Shpenzimet e zhvlerësimit dhe rivlerësimi

Kosto e ndërtesës= 120,000-40,000 Toka=80,000

Zhvlerësimi vjetor (Ndërtesat)=4%*80,000=3,200

Zhvlerësimi vjetor (Impijantet)=20%*(32,000-18,000)=20%*14,000=2,800

Total shpenzimet e zhvlerësimit=3,200+2,800=6,000

Rivlerësimi:

Vlera e tregut e tokës 54,000

Kosto e tokës (40,000)

Rezerva e rivlerësimit 14,000

LL/4

Shpenzimet e interesit=5%20,000=1,000

D: Shpenzimet e interesit 1,000

K:Interesi i pagueshëm 1,000

LL/5 D: Shpenzimet e tatimit 2,700

K: Tatimi i pagueshëm 2,700

(LL/6) Pasurite jo qarkulluese

	`000
Toka dhe ndërtesat (Kosto)	120,000
Rivleresimi	14,000
Zhvleresimi i akumuluar sipas BV	(22,500)
Shpenzimi i zhvl	(3,200)
Impijantet e prodhimit dhe pajisjet(kosto)	32,000
Zhvleresimi i akumuluar sipas BV	(18,000)
Shpenzimi i zhvl	<u>(2,800)</u>
	<u>119,500</u>

(LL7) LL/A

LL/A sipas BV	20,280
Borxhi i keq	(540)
	<u>19,740</u>

(LL8) Fitimi i mbajtur

Fitimi i mbajtur S`	12,920
Fitimi neto	10,588
Dividenda	<u>(3,000)</u>
	<u>20,508</u>

Problemi 3

Në fund të vitit 2021, kompania Drini shpk ka të dhënat si në vijim. Numërimi i stokeve ka vërtetuar se shumat e stokeve të mbajtura aktualisht, me kosto, janë si më poshtë:

	Eur
Produkti A1	8,000
Produkti A2	14,000
Produkti B1	16,000
Produkti C1	6,000

Produktet A1 dhe C1 nuk janë duke u shitur në ciklin normal të biznesit për shkak të disa ndryshimeve strategjike. Stokset e produktit A1 do të mund të shiten me çmim të vlerësuar të tregut prej 7,800 eur minus shpenzimet e shitjes 500 eur. Stokset e produktit C1 mund të shiten për 7,000 eur minus shpenzimet e shitjes prej 200 eur.

Kërkohet:

Cila është shuma e stokeve që duhet të paraqitet në pasqyrat financiare?

Zgjidhja e problemit 3

Total (10 pikë)

Produkti	Me e ulëta nga kosto ose VNR	Shuma e stokeve
A1	8,000 ose (7,800 - 500)	7,300
A2	-	14,000
B1	-	16,000
C1	6,000 se (7,000 - 200)	6,000
Vleresimi i stokeve ne pasqyra financiare		<u>43,300</u>

Problemi 4

Durimi Sh.P.K. operon në industrinë e shitjes me pakicë dhe pasqyrat e tij financiare janë si mëposhtë:

Pasqyra e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2021, Durimi Sh.P.K.

	2021 €'000	2020 €'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Prona, Fabrika dhe Pajisjet	1,940	1,285
Total Pasuritë jo-qarkulluese	1,940	1,285
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	327	371
Të arkëtueshmet tregtare	189	203
Paraja e gatshme & Ekuivalentët e saj	44	36
Total Pasuritë qarkulluese	560	610
Total Pasuritë	2,500	1,895
Ekuiteti & Detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar	800	600
Premia e aksioneve	100	60
Fitimet e mbajtura	673	413
Rezerva e Rivlerësimit	130	-
Total Ekuiteti	1,703	1,073
Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	420	500
Total Detyrimet afatgjata	420	500
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshmet tregtare	242	212
Overdrafti bankar	95	80
Tatimi i pagueshëm	40	30
Detyrimet afatshkurtra	377	322
Total Ekuiteti & Detyrimet	2,500	1,895

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021,
Durimi Sh.P.K.**

	€'000
Të hyrat	7,800
Kosto e shitjes	<u>(6,900)</u>
Fitimi bruto	900
Kostot e shpërndarjes	(342)
Shpenzimet administrative	(168)
Shpenzimet e interesit	<u>(30)</u>
Fitimi para tatimit	360
Tatimi në fitim	(80)
Fitimi për vitin	<u>280</u>

Shënimet:

1. Prona, Fabrika & Pajisjet me vlerë neto ne libra prej €200,000 ishte shitur për €160,000. Kjo pasuri kishte kosto origjinale prej €320,000.
2. Zhvlerësimi për Pronën, Fabrikën & Pajisjen gjatë vitit arriti vlerën prej €240,000.
3. Dividendët e paguar gjatë vitit arritën vlerën në €20,000 dhe janë raportuar në Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet.

Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 për Durimi Sh.P.K. në përputhje me SNK 7 *Pasqyra e Rrjedhës së Parasë*.

(Total: 20 pikë)

Pasqyra e rrjedhës së parasë për Durimi Sh.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2013

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		'000	'000
Fitimi para tatimit		360	
Rregullimet për Zhvlerësimin		240	
Humbjen nga shitja e PFP		40	
Shpenzimet e interesit		30	
		670	
Zvogëlimi në të arkëtueshmet tregtare		14	
Zvogëlimi në stoqe		44	
Rritja në të pagueshmet tregtare		30	
Paraja e gjeneruar nga operacionet		758	
Pagesa e interesit	-	30	
Pagesa e tatimit në fitim	-	70	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			658
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Pagesat për blerjen e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	-	965	
Pranimet nga shitja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve		160	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investive		-	805
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Të ardhurat nga emitimi i aksioneve		240	
Pagesat nga zvogëlimi në kreditë afatgjata	-	80	
Pagesa e Dividendës	-	20	
			140
Rritja neto e keshit & ekuivalentëve të keshit		-	7
	Shënimi		
Keshi & Ekuivalentët e keshit në fillim të vitit	1	-	44
	Shënimi		
Keshi & Ekuivalentët e keshit në fund të vitit	1	-	51
Shënimi 1		2013	2012
		'000	'000
Paraja në dorë dhe saldot në bankë		44	36
Overdrafti bankar	-	95	80
Keshi & Ekuivalentët e keshit	-	51	44

Llogaritjet

Humbja nga shitja e PFP		'000
Kosto		320
- Zhvlerësimi i akumuluar	-	120
Vlera neto në libra në datën e shitjes		200
Të ardhurat nga shitja		160
Humbja nga shitja e PFP		40

Llogaria e interesit

	'000		'000
Saldo b/d		-Shpenzimet	30
Pagesa e interesit	30	Saldo c/d	-
	30		30

Llogaria e tatimit në fitim

	'000		'000
Pagesa e tatimit	70	Saldo b/d	30
Saldo c/d	40	Shpenzimet	80
	110		110

Llogaria e Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve

	'000		'000
Saldo b/d	1,285	Zhvlerësimi	240
Rezerva e Rivlerësimit	130	Shitja - vnl	200
Blerja e PFP	965	Saldo c/d	1,940
	2,380		2,380

Problemi 5

Kur Andon Andoni, një biznes individual, viti financiar i të cilit është më 31 dhjetor çdo vit, ekstraktot një bilanc vërtetues më 31 dhjetor 2021, ai pa se saldo debitore është më e lartë se saldo kreditore për €5,038. Diferenca ishte regjistruar në llogarinë pezull. Diferencat e mëposhtme dolën nga hetimi:

1. Kthimet e blerjeve prej €189 ishin përfshirë në kthimet e shitjeve.
2. Gjatë nënshkrimit të ditarit të çeqeve, z.Andoni kuptoi se ai kishte harruar të regjistrojë pagesën e dy çeqeve prej €125 dhe €249 në lidhje me shpenzimet e elektrike dhe shpenzimet e telefonit.
3. Regjistrimi në lidhje me pagesën e parapagimit e qirasë prej €500 i ishte debituar llogarisë pezull dhe kredituar në llogarinë e qirasë se pagueshme gabimisht.
4. Makina me vlerë prej €4,600 u prezantua në biznesin e tij dhe regjistrimet e vetme të bëra ishin debitimi në llogarinë e pajisjeve dhe kreditimi i llogarisë pezull, si dhe kontabilizimi për zhvlerësimin. Makinat zhvlerësohen me një normë prej 12.5% të saldosh zbritëse, ndërsa pajisjet zhvlerësohen me një normë prej 10% në vit me metodën lineare. Politika e zhvlerësimit të z.Andoni, është zhvlerësimi i plotë në vitin e blerjes.
5. Fatura për dritat dhe nxemjen prej €240 ishte gjetur. Nuk ishte procesuar në konton të shpenzimit mirëpo ishte paraqitur saktë në librin e arkës. Fatura e z.Andoni për dritat dhe nxemjen për secilin muaj paguhet automatikisht nga një urdhërpagesë prej llogarisë bankare, në ditën e fundit të secilit muaj.
6. Z.Andoni kontabilizoi dhe shiti mallra me afat pagese me vlerë prej €1,240 me bazë shitjeje ose kthimi, ku data e fundit e lejuar për kthim për këto mallra ishte 01 shkurt 2022. Sipas SNK 18 këto mallra nuk duhet njohur në të hyrat për vitin 2021, ndërsa ai i kishte regjistruar edhe të hyrat nga shitja edhe koston e mallit të shitur në këto mallra. Këto mallra i kishin kushtuar z.Andonit €900.
7. Një rënie në lejimin e borxheve të dyshimta prej €800 ishte debituar në llogarinë e borxheve të këqija dhe kredituar në llogarinë pezull.

Kërkohet:

- (a) Përgatitni hyrjet në ditar për z. Andon Andoni për regjistrimet dhe/ose përmirësimet, siç është e përshtatshme, transaksionet relevante nga informatat e mësipërme për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021. (14 pike)
- (b) Përgatitni konton e llogarisë pezull, ku tregohen korrigjimet e bëra. (6 pike)
- (c) Përgatitni konton e llogarisë pezull, ku tregohen korrigjimet e bëra. (6 pike)

[Total: 20 pikë]

Për t'u korrigjuar		
D. Llogaria pezull	378	
K. Kthimet e shitjeve		189
K. Kthimet e blerjeve		189

Për t'u korrigjuar		
D. Shpenzimet elektrike	125	
D. Shpenzimet e telefonit	249	
K. Paraja		374

Për t'u korrigjuar		
D. Parapagimi i qirasë	500	
D. Qiraja e pagueshme	500	
K. Llogaria pezull		500
K. Paraja		500

Për t'u korrigjuar		
D. Makina (kosto)	4,600	
D. Llogaria pezull	4,600	
K. Paraja		4,600
K. Pajisjet (kosto)		4,600
D. Shpenzimet e zhvlerësimit	115	
D. Zhvlerësimi i akumuluar - Pajisjet	460	
K. Zhvlerësimi i akumuluar - Makina		575

Për t'u korrigjuar		
D. Shpenzimet e Ditave & nxemjes	240	
K. Llogaria pezull		240

Për t'u korrigjuar		
D. Shitjet	1,240	
K. Të arkëtueshmet tregtare		1,240
D. Stoqet	900	
K. KMSH		900

Për t'u korrigjuar		
Dr. Llogaria pezull		800
Cr. Shpenzimet per Borxhet e këqija		800
Dr. Lejimet për borxhet e dyshimta		800
Cr. Te hyrat nga borxhet e dyshimta		800

LLogaria pezull

	S`5,038
1) 378	3) 500
4) 4,600	5)240
6) 800	
	S`0